

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, me gjyqtarin Arben Hoti, në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues, dhe sekretaren juridike Shqipe Rexhepi, në lëndën penale kundër të pandehurit Z. S., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374/1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP/I.Nr. 883/14 të dt. 17.03.2015, pas shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 05.04.2017, në të cilën ishin të pranishëm Prokurori i Shtetit - Ilaz Beqiri, dhe i pandehuri Z. S., të nejtën datë mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri: Z. S., i biri i H. dhe N., e gjinisë H., i lindur me dt. *data e lindjes...* në fshatin P. Komuna V., me vendbanim në P., rr "...", i martuar, baba i tre fëmijëve, i pa punë, pensiomist, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal *numri personal...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse: Nga data e papërcaktuar e deri me dt. 11.08.2014, në shtëpinë e tij pa autorizim ka poseduar armën, në atë mënyrë që vullnetarisht ka lajmëruar policinë se posedon një armë dhe atë dëshiron ta dorëzoj dhe kur pjesëtarët e PK kanë shkuar te shtëpia e tij i njëjti i ka dorëzuar revolen e tipit "Ekol Special", ngjyrë e zezë, me nr. Serik EV-126052, me një karikator dhe 46 fishekë të kalibri 9 mm.

- Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374/1 të KPRK-së

Andaj, gjykata bazuar në nenin e lartpërmendur dhe nenet **7,17,21,41,43,45,50,51,52,73 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPK –së**, e gjykon me:

DËNIM ME KUSHT

Të pandehurit **Z. S.T**, i caktohet dënim burgimi në kohëzgjatje **prej 5 (pesë) muajve**, i cili nuk do të ekzekutohet në rast se i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale, në periudhën **prej 1 (një) viti**.

Obligohet i pandehuri që të paguajë shpenzimet e procedure penale dhe atë paushallin gjyqësor në shumën prej **30 euro**, në afatin prej 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Komfor nenit 69 të KPRK-së dhe nenit 115 të KPPK-së konfiskohet:

Pistoleta e tipit "Ekol Special", ngjyrë e zezë, me nr. Serik EV-126052, me një karikator dhe 46 fishekë të kalibri 9 mm , si dhe sendet te evidentuara ne vërtetimin mbi marrjen e përkohshme të sendeve të datës 11.08.2014.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngritur aktakuzë PP/I. nr. 883/2014, të datë 17.03.2015, me të cilën e ka akuzuar të pandehurin Z. S., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374/1 të KPRK-së.

Me datë 05.04.2017, Gjykata Themelore në Prishtinë ka caktuar dhe mbajtur seancën fillestare në këtë çështje penale, në të cilën Prokurori i Shtetit ka lexuar akuzën PP/I .nr. 883/14, të datë 17.03.2015, ndërsa Kryetari i Trupit Gjykues pasi që u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, të njëjtit i dha mundësinë konform nenit 246 par.4 të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri Z. S., në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i është vënë në barrë, duke shtuar se vet e ka lajmëruar policinë se posedon një armë, duke lutur gjykatën që ndaj tij të merr një dënim sa më të butë, duke i premtuar Gjykatës se nuk do të përsërisë vepër penale.

Prokurori i shtetit Ilaz Beqiri pas deklarimit të të pandehurit, deklarojë se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, konsideroj se pranimi i fajësisë është komfor KKPRK-së, si dhe në përputhje me provat e propozuara nga prokuroria, andaj i propozojë gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë, dhe i propozojë gjykatës që si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë dhe se i njëjti vet e ka lajmëruar policinë që posedon armë.

Megjenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë gjykata konstatoi se janë plotësuar kriteret nga neni 248 par. 1 të KPPK-së, I pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi mbështetet në provat dhe faktet që përmban akuza siç janë: vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të sendeve të dt. 11.08.2014, si dhe dokumentacioni tjetër që gjendet në shkresat e lëndës.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara sipas nenit 73 të KPRK-së që ndikojnë në matjen e dënimit, ku si rrethana veçanërisht lehtësuese për të pandehurin mori pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pendimin e thellë të shprehur nga ana e të pandehurit, faktin se i njëjti i ka lajmëruar policinë se posedon armë, dhe të njëjtit i ka ftuar që ta konfiskojnë atë, rrethanat e tij familjare, i pandehuri është i martuar baba i tre fëmijëve, moshën e tij të shtyrë, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata në këtë rast nuk gjeti. Gjykata të pandehurit i shqiptoi dënim burgimi me kusht si në pjesën dënuese të këtij aktgjykimi, duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, rrethanat në të cila është kryer vepra penale, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi ndëshkimor, në kuptim të preventivës individuale, që të parandaloj të pandehurin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës gjeneralë që të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi konfiskimin e sendeve u mor komfor nenit 115 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mor komfor nenit 450 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
PKR. nr.168/15, datë 05.04.2017

Sekretarja Juridike:
Shqipe Rexhepi

Gjyqtari:
Arben Hoti

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, prej momentit të marrjes së këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.